

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

Api – Kži – 6/2012

16 janar 2013

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë prej gjyqtarit të EULEX-it Martti Harsia si kryetar i kolegjit, dhe gjyqtarës së EULEX-it Elka Filcheva-Ermenkova, gjyqtarit të EULEX-it Charles Smith III, gjyqtarëve të Gjykatës Supreme Avdi Dinaj dhe Gyltene Sylejmani si anëtarë të kolegjit, të ndihmuar nga zyrtarja ligjore Noora Aarnio në cilësi të procesmbajtëses,

në lëndën penale kundër të pandehurve B. H.dhe Sh.Q.

Të dytë të dënuar nga Gjykata e Qarkut të Prishtinës, për veprat penale të **vrasjes së rëndë** në bashkëkryerje [neni 147 paragrafët 4, 9, dhe 11 lidhur me nenin 23 të Kodit Penal të Kosovës (KPK)], të **lëndimit të rëndë trupor** në bashkëkryerje [neni 154 paragrafi 1 lidhur me nenin 23 të Kodit Penal të Kosovës (KPK-së)] dhe të **shkaktimit të rrezikut të përgjithshëm** në bashkëkryerje [neni 291 paragrafët 1 dhe 5 lidhur me nenin 23 të Kodit Penal të Kosovës (KPK-së)]; dhe të dytë të dënuar me burgim afatgjatë me njëzet e pesë (25) vjet burgim, i cili aktgjykim ishte ndryshuar nga Gjykata Supreme e Kosovës.

Duke vepruar sipas ankesave të të pandehurve të ushtruara përmes avokatëve të tyre mbrojtës M.H.më 24 korrik 2012, dhe A.I.më 25 korrik 2012, kundër aktgjykimit të Gjykatës Supreme në lëndën nr. Ap-Kz.nr. 246/2010, të datës 25 maj 2012.

Pas mbajtjes së seancës publike më 18 dhjetor 2012 dhe 15 janar 2013, në praninë e Prokurores së Shtetit Judit EvaTatrai, e të pandehurit Sh.Q. dhe të avokatit mbrojtës M.H.dhe M.Dnë zëvendësim të avokatit A.I., dhe pas mbajtjes së këshillimit dhe votimit të mbajtur në të njëjtën ditë,

Më 15 janar 2013 shpall këtë

AKTGJYKIM

- 1) **B.H.**, me nofkën “B.F.”, emri i babait A., emri dhe mbiemri i vajzërisë së nënës N.V., i lindur më xxxxx, në xxx, shqiptar i Kosovës, vendbanimi i fundit në fshatin xxxx, i pamartuar, ka të kryer shkollën e mesme, profesioni i mëparshëm polic i Kosovës, me gjendje të mesme ekonomike, në paraburgim vazhdimisht prej datës 21 janar 2008;
- 2) **Sh.Q.** nuk ka nofkë, emri i babait M., emri dhe mbiemri i vajzërisë së nënës Sh. I., i lindur më 18 shtator 1974, në Ferizaj, shqiptar i Kosovës, vendbanimi i fundit në Rrugën e xxxxxxxx i martuar ka tre fëmijë, ka të kryer shkollën e mesme, profesioni i

mëparshëm polic, me gjendje të mesme ekonomike, në paraburgim vazhdimisht prej datës 21 janar 2008;

Ankesat e paraqitura nga avokatët mbrojtës M.H.dhe A.I.në emër të të pandehurve kundër aktgjykimit të Gjykatës Supreme në lëndën Ap-Kz.nr. 246/2010, të datës 25 maj 2012 **refuzohen si të pabazuara.**

I. HISTORIA E PROCEDURËS

Gjykata e Qarkut

Më 12 gusht 2008, Prokurori Publik ka ngritur aktakuzë kundër të pandehurve B.H., Sh.Q.dhe të tjerëve.

Më 5 janar 2008 Kryetari i Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it lëshoi një Aktvendim mbi caktimin e lëndës te gjyqtarët e EULEX-it.

Më 2 shkurt 2009 gjyqtari për konfirmim të aktakuzës i konfirmoi pikat 2-4 të aktakuzës kundër të gjithë të pandehurve.

Më 5 maj 2009 filloi shqyrtimi gjyqësor. Aktgjykimi u shpall më 22 shtator 2009. B. H.dhe Sh.Q.u shpallën fajtorë për vrasje të rëndë, lëndim të rëndë trupor dhe për shkaktim të rrezikut të përgjithshëm, dhe u dënuan me një dënim unik me 25 vjet burgim. Të pandehurit paraqitën ankesa kundër këtij aktgjykimi.

Gjykata Supreme

Seanca e Gjykatës Supreme u mbajt më 22 maj 2012 dhe aktgjykimi u shpall më 25 maj 2012. Gjykata Supreme e Kosovës i refuzoi ankesat e të pandehurve si të pabazuara. Megjithatë, Gjykata Supreme e ndryshoi aktgjykimin duke pohuar se Pika 1, vrasje e rëndë, e konsumon Pikën 3, shkaktim i rrezikut të përgjithshëm. Aktgjykimi u konfirmua në pjesët e mbetura.

Shkresat e lëndës nuk përmbajnë fletë dërgesën e dorëzimit të aktgjykimi te i pandehuri **B.H..** Avokati mbrojtës M.H.Avokati mbrojtës të Gjykatës Supreme më 24 korrik 2012.

Shkresat e lëndës nuk përmbajnë fletë dërgesën e dorëzimit të aktgjykimi te i pandehuri **Sh.Q..** Avokati mbrojtës A.I.Avokati mbrojtës të Gjykatës Supreme më 25 korrik 2012.

Më 16 nëntor 2012 Gjykata Supreme e pranoi mendimin e Prokurores së Shtetit.

II. ANKESAT

i. Ankesa e B.H.t

Ankesa e avokatit mbrojtës M.H.e kundërshton aktgjykimin e shkallës së parë në disa baza. Ai pohon se aktgjykimi i shkallës së parë përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe të kodit penal, se gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë, dhe se sanksioni penal është shqiptuar në mënyrë të **paligjshme**.

Avokatët mbrojtës kërkojnë që aktgjykimi të ndryshohet me lirimin e të pandehurve në përputhje me nenin 390 paragrafin 1 pikën 3 të KPPK-së, ose të anulohet aktgjykimi dhe lënda të kthehet për rigjykim.

Bazat e paraqitura për ankesë janë të përmbledhura si në vijim:

Shkeljet esenciale të procedurës penale:

- Aktgjykimi nuk përmban arsyetim mbi pikat e ngritura në ankesë nga mbrojtja. Prandaj ai i përsërit argumentet e parashtruara në ankesën kundër aktgjykimit të shkallës së parë.
- Komunikimi ndërmjet Gjykatës dhe prokurorit i cenoi të drejtat e të pandehurit pasi që dokumentet nuk kanë vullat e duhura të dorëzimit dhe të pranimit.
- Kolegji nuk ishte i përbërë në përputhje me Ligjin pasi neni 345 paragrafi 1 i KPPK-së ishte shkelur kur ndryshoi përbërja e kolegjit. Kjo është shkelje e nenit 403 paragrafit 1 pikës 1 të KPPK-së.
- Në ankesën e parë pretendohet se aktgjykimi është i bazuar në prova të papranueshme. Gjykata e shkallës së dytë shkeli nenin 176 paragrafin 1 të KPPK-së sepse prokurori nuk ka autorizim të urdhërojë ekspertizën.
- Tamponët nga vetura e policisë 4 muaj pas shpërthimit janë të papranueshëm si prova.
- Aktgjykimi e tejkalon aktakuzën lidhur me motivin.
- Aktgjykimi përmban shkelje të nenit 304 paragrafit 1 pikës 12 të KPPK-së.

Gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë;

- Gjetja e dëshmitarëve A.J, M.J.dhe I.G.si të anshëm dhe subjektivë është e gabuar.
- Ekspertiza e shpërthimit nga vetura e policisë është provë e papranueshme dhe prandaj nuk mund të merret parasysh.
- Aktgjykimi nuk ofron arsyetim bindës sa i përket besueshmërisë së deklaratës së dëshmitares M.I.dhe raportit të policit I. të datës 9.11. 2009.
- Gjykata ka zgjedhur provat në mënyrë selektive pa ofruar arsyetim sa i përket besueshmërisë së provave.
- Janë edhe së paku 4 të dyshuar të tjerë në lidhje me këtë lëndë e të cilët ende nuk janë gjykuar. Aktgjykimi duhet të priset dhe lëndët të gjykohen bashkë.

ii. Ankesa e Sh.Q.t

Ankesa e avokatit mbrojtës A.I.e kundërshton aktgjykimin e shkallës së parë në disa baza. Ai pohon se aktgjykimi i shkallës së parë përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe të kodit penal, se gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë.

Avokatët mbrojtës kërkojnë që aktgjykimi të ndryshohet me lirimin e të pandehurve, ose të anulohet aktgjykimi dhe lënda të kthehet për rigjykim.

Bazat e paraqitura për ankesë janë të përmbledhura si në vijim:

Shkeljet esenciale të procedurës penale:

- Gjykata Supreme ka refuzuar ankesën padrejtësisht dhe pa asnjë bazë faktike ose ligjore.
- Mbrojtja nuk ishte e pranishme kur dëshmitarët M.I., A.M., “O.” dhe “Th.” ishin dëgjuar në polici dhe te prokurori publik. Pasi mbrojtje nuk kishte mundësi për t’i kundërshtuar këto deklarata, ato janë të papranueshme në përputhje me nenin 156 dhe nenin 157 të KPPK-së.
- Aktgjykimi bazohet në deklaratën e dëshmitares M.I.. Prandaj aktgjykimi është i bazuar në prova të papranueshme dhe bën shkelje të nenit 403 paragrafit 1 nën paragrafit 8 të KPPK-së.
- Dispozitivi nuk përmend kur ishte vendosur dhe detonuar mjeti shpërthyes, llojin e eksplozivit ose si ishte aktivizuar ai, apo motivin e një akti të tillë. Vlerësimi i Gjykatës Supreme se shkeljet e nenit 403 paragrafit 1 nën paragrafit 12 të KPPK-së nuk janë mjaft të rënda për të ndikuar në qartësinë ose kuptueshmërinë e dispozitivit nuk është i bazuar në KPPK pasi kodi nuk përcakton prapësinë por shkelja e nenit të përmendur e bën aktgjykimin automatikisht të paligjshëm.
- Gjetjet dhe mendimet e ekspertizës të siguruara nga prokurori janë prova të papranueshme pasi që janë urdhëruar nga prokurori e jo nga gjykata.
- Aktgjykimi e tejkalon aktakuzën, siç përcaktohet me nenin 386 paragrafin 1 të KPPK-së, kur arrin në përfundim se të pandehurit kanë kryer vrasjen e të ndjerit N.B.dhe të dy kushërinjve të tij.

Gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë;

- Gjykata e Qarkut ka gjetur se nuk ekziston asnjë provë e drejtpërdrejtë për fajësinë e të pandehurve por vetëm indikatorë.
- këta indikatorë janë të dyshimtë, kundërtë, të palogjikshëm, “nuk përputhen me rrjedhën e rregullt të gjërave” dhe tërësisht të pasigurta;
- për shkak të mungesës së motivit prova e paraqitur nuk e vërteton gjendjen faktike siç paraqitet në dispozitiv;
- deklaratat e dëshmitarëve janë kundërtë dhe të pasigurta kështu që nuk mjaftojnë për ta vërtetuar gjendjen faktike siç pohohet në dispozitiv;
- në aktgjykim gjetja e vrasjes së N.B.nga H. dhe Q. nuk mund të jetë e saktë pasi prokurori ka treguar të tjerë persona për këtë vepër penale;

- prova e ekspertit nuk ka ofruar asnjë provë të drejtpërdrejtë për fajësinë e të pandehurve;
- analiza e helmimit të telefonit celular nuk e vendos Q.n në vendin e krimit;
- deklarata e M.I.t nuk është e besueshme sepse “nuk korrespondon me gjendjen reale të fakteve”, është e pabesueshme, “aspak e mundshme pasi që është e sajuar” dhe

Shkeljet e ligjit penal;

- vepra penale e shkakimit të rrezikut të përgjithshëm (neni 291 paragrafët 1 dhe 5 të KPK-së) i absorbon të gjitha veprat e përshkruara në aktakuzë, përfshirë edhe veprat penale të përshkruara në nenet 147 dhe 154 të KPK-së.

III. PËRGJIGJET

i. Përgjigja e Prokurorit të Qarkut.

Nuk ka përgjigje nga Prokurori i Qarkut.

ii. Përgjigja e Prokurorit të Shtetit

Prokurori i Shtetit propozon që ankesat të refuzohen dhe aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Sa i përket shkeljeve të pretenduara esenciale të procedurës penale prokurori pohon se vulat në urdhra janë në rregull dhe prandaj pretendimi për papranueshmërinë e tyre është i pabazuar. Po ashtu, të drejtat e mbrojtjes nuk janë cenuar me vazhdimin e procedurës pas ndryshimit të përbërjes së kolegjit. Përveç kësaj, në përputhje me nenin 237 të KPPK-së, prokurori ka autorizim të përgjithshëm për të emëruar ekspertë gjatë procedurës paraprake dhe prandaj ekspertiza nuk është provë e papranueshme. Për më shumë, kur gjykata ka autoritet për të konsideruar çdo provë të pranueshme që ajo mendon se është relevante, duke përdorur provat e mbledhura në një hetim tjetër nuk e bën këtë provë të papranueshme. Po ashtu, Gjykata e Qarkut ka bërë vlerësim të plotë të shpjegimeve të secilit të pandehur dhe ka dhënë arsyetim gjithëpërfshirës pse i ka dhënë peshë ose nuk i ka dhënë peshë dëshmimeve të tilla. Përveç kësaj, dispozitivi është i qartë dhe i kuptueshëm si dhe tërësisht konsekuent me arsyetimin. Në fund, pasi mbrojtja e kishte mundësinë për t'i marrë dëshmitarët në pyetje në shqyrtim gjyqësor, të drejtat e tyre janë respektuar.

Sa i përket vërtetimit të gjendjes faktike, Prokurori i shtetit pohon se avokati mbrojtës thjesht shpreh pakënaqësinë e përgjithshme për vlerësimin e gjykatës pa i cekur arsyet se pse ky vlerësim është i pasaktë. Gjykata e Qarkut ka dhënë arsye gjithëpërfshirëse se pse i ka dhënë apo nuk i dhënë peshë dëshmimeve. Gjithashtu, dëshmitarja I. dhe vajzat e saj janë kërcënuar nga të pandehurit.

Sa i përket shkeljeve të ligjit penal, Prokurori i shtetit vëren se vrasja e rëndë dhe lëndimet e rënda trupore nuk janë konsumuar nga vepra penale Shkaktim i rrezikut të përgjithshëm sepse të pandehurit kanë vepruar me qëllim të vrasjes.

IV. GJETJET E GJYKATËS

A. Lejueshmëria e ankesës

1. Për të garantuar të drejtat e të pandehurve për një mjet juridik efektiv siç është përcaktuar me nenin 398 të KPPK-së, ankesat duhet të supozohen si të paraqitura me kohë. Ankesat janë paraqitur nga avokatët e tyre mbrojtës, personat e autorizuar.

2. Kolegji tani do të vlerësojë secilin argument të ngritur në ankesën e mbrojtjes.

B. Shkeljet esenciale të procedurës penale

3. Gjykata Supreme vëren se Gjykata Supreme në aktgjykimin e saj të datës 25 maj 2012 i është përgjigjur të gjitha argumenteve të përmbledhura në ankesë.

4. Gjykata Supreme gjithashtu vëren se vlefshmëria e urdhrit të gjykatës nuk varet nga vula e dërgimit të atij urdhri te Prokurori. Gjykata Supreme nuk ka asnjë arsye që të vë në pikëpyetje ekzistimin e ligjshmërisë së urdhrave në shkresat e lëndës. Për më tepër, Gjykata Supreme në aktgjykimin e saj të datës 25 maj 2012¹ ka vërejtur se dokumentet mbajnë vulën e përdorur në kohën e lëshimit të tyre.

5. Në lidhje me pretendimet për përbërjen e kolegjit, Gjykata Supreme vëren se Gjykata Supreme në aktgjykimin e saj të datës 25 maj 2012² ka dhënë arsyetim mbi ligjshmërinë e procedurës. Gjithashtu, sipas procesverbalit kryetari i kolegjit ka theksuar se “*Kjo situatë bie nën nenin 345 dhe sipas pjesë së dytë të paragrafit të parë të këtij neni, unë kërkoj nga palët që ta japin mendimin e tyre lidhur me këtë çështje. Tani ne do të vendosim se si të procedojmë, nëse do t’ia fillojmë nga fillimi apo do t’i lexojmë dëshmitë e mëparshme në procesverbal.*”³ Prokurori vëren se “... Unë nuk kam asgjë kundër që të lexohet procesverbali dhe kjo do të jetë në interes të drejtësisë ...”⁴ Avokati mbrojtës M.H.(për H.n) mendon se “*I nderuar, pasi që ligji është i qartë, ne jemi në këtë situatë*

¹ Aktgjykimi datës 25 maj 2012, faqe 12 e versionit në gjuhën angleze

² Aktgjykimi datës 25 maj 2012, faqe 12-13 e versionit në gjuhën angleze

³ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor 19 gusht 2009, faqe 2 e versionit në gjuhën angleze

⁴ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor 19 gusht 2009, faqe 2 e versionit në gjuhën angleze

dhe nuk kemi asgjë kundër.”⁵ Avokati mbrojtës A.I.(për Q.n) thekson se “I nderuar, për ta mos përsëritur kolegun tim unë e mbështes deklaratën e tij dhe nuk kam asgjë kundër që të lexohet procesverbali.”⁶ Avokati mbrojtës A.V.(për C.) thekson se “I nderuar, unë pajtohem me propozimin që mos ta ri-fillojmë gjykimin dhe mendoj se është e logjikshme që të vazhdojmë aty ku ka mbetur.”⁷ Avokatja mbrojtëse V.B.(për C.) thekson se “Unë pajtohem me propozimin e kolegëve të mi.”⁸ Pas pak kohe avokati mbrojtës D.J.(për H.n) kërkon nga kolegjii “Pasi që kemi të bëjmë me një dispozitë obligative të ligjit, a është futur në procesverbal se gjykimi nuk do të filloj përsëri?”⁹ Dhe pastaj ai vetë përgjigjet se “Unë pajtohem me kolegët e mi ...”¹⁰ Në tërë këtë, kryetari i kolegjii përgjigjet se “Për hir të qartësisë dhe pas kërkesës së D.J.në bazë të nenit 345 theksoj se gjykimi **do të filloj nga fillimi**, mirëpo si kemi cekur më parë dëshmitarët nuk do të dëgjohen përsëri ...”¹¹

6. Prandaj, Gjykata Supreme pajtohet me arsyetimin dhe përfundimin e bërë në aktgjykimin e datës 25 maj 2012, se të drejtat e palëve nuk janë shkelur në atë mënyrë që do ta bënte gjykimin e padrejtë. Andaj, nuk ekziston asnjë arsye që lënda të kthehet në Gjykatën e Qarkut për rigjykim.

7. Sa i përket pranueshmërisë së ekspertizës së urdhëruar nga Prokurori dhe mostrat e marra nga vetura e policisë, Gjykata Supreme vëren se sipas nenit 153 paragrafit 1 të KPPK-së “Provat e marra me shkelje të dispozitave të procedurës penale janë të papranueshme kur ky Kod ose dispozita të tjera të ligjit shprehimisht parashikojnë kështu.” Kodi nuk përcakton se ekspertiza e marrë pa urdhër të shkruar nga gjykata është e parpanueshme. E as Gjykata Supreme nuk e konsideron saktësinë e kësaj ekspertize të kontestueshme. Gjithashtu, Gjykata e Qarkut ka dhënë arsyetim se pse ekspertiza e mostrave nga vetura e policisë është e pranueshme.¹² Gjykata Supreme pajtohet me këtë arsyetim.

8. Më tutje, aktakuza tregon nenin 149 paragrafi 9 si njëri nga bazat për ndryshim. Aty shkruan “Privon nga jeta personin për shkak të hakmarrjes së paskrupullt apo motiveve tjera të **ulëta**”. Pasi që motivi për aktivitetin e të pandehurve përmendet si njëri nga bazat e aktakuzës, Gjykata e Qarkut nuk ka tejkalluar aktakuzën gjatë vendosjes lidhur me të.

⁵ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor 19 gusht 2009, faqe 2 e versionit në gjuhën angleze

⁶ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor 19 gusht 2009, faqe 2 e versionit në gjuhën angleze

⁷ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor 19 gusht 2009, faqe 2 e versionit në gjuhën angleze

⁸ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor 19 gusht 2009, faqe 2 e versionit në gjuhën angleze

⁹ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor 19 gusht 2009, faqe 2 e versionit në gjuhën angleze

¹⁰ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor 19 gusht 2009, faqe 3 e versionit në gjuhën angleze

¹¹ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor 19 gusht 2009, faqe 3 e versionit në gjuhën angleze

¹² Aktgjykimin e datës 22 shtator 2009, faqet 39-41 të versionit në gjuhën angleze

9. Gjykata Supreme rikujton se nenit 156 paragrafi 2 i KPPK-së përcakton “*Deklarimi i dëshmitarit i dhënë në polici ose para prokurorit publik mund të jetë provë e pranueshme në gjykatë vetëm kur të pandehurit ose mbrojtësit i është dhënë mundësia ta kundërshtojë atë nëpërmjet marrjes në pyetje të dëshmitarit gjatë ndonjë faze të procedurës penale.*”¹³

10. Gjithashtu, neni 157 i KPPK-së përcakton “*Gjykata nuk e shpall të akuzuarin fajtor duke u mbështetur vetëm në një dëshmi ose duke i dhënë rëndësi vendimtare një dëshmie a një prove tjetër e cila nuk mund të kundërshtohet nga i pandehuri ose mbrojtësi përmes marrjes në pyetje gjatë ndonjë faze të procedurës penale.*”¹⁴

11. Pasi që mbrojtja ka pasur mundësi që të marr në pyetje dëshmitarët M.I., A. M., “O.” dhe “Th.” gjatë shqyrtimit gjyqësor, kushtet e përcaktuara me nenet 156 dhe 157 të KPPK-së janë përmbushur.

12. Gjykata Supreme rikujton siç është theksuar në aktgjykimin e Gjykatës Supreme të datës 25 maj 2012, nenet 391 dhe 396 të KPPK-së përcaktojnë përmbajtjen e dispozitivit. Dispozitivi duhet të përmbajë shënimet në vijim: të dhënat personale të të akuzuarit; vendimin me të cilin i akuzuari është shpallur fajtor; aktin për të cilin ai është shpallur fajtor, së bashku me faktet dhe rrethanat të cilat tregojnë natyrën kriminale të aktit të kryer si dhe faktet dhe rrethanat nga të cilat varet zbatimi i dispozitave përkatëse të ligjit penal; cilësimin juridik të aktit dhe dispozitat e ligjit penal të zbatuara gjatë marrjes së aktgjyimit; dënimin e shqiptuar ndaj të akuzuarit; vendimin për të përfshirë në dënim kohën e kaluar në paraburgim; dhe vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale dhe mbi kërkesën pronësore. Prandaj, Gjykata Supreme është e mendimit se qëllimi i dispozitivit nuk është që të sqaroj në detaje aktivitetet e të pandehurit për çdo minutë, por t’ia mundësoj të pandehurit që ta kuptoj se cili është akti për të cilin është shpallur fajtor dhe pse ky akt është vepër penale.

13. Më tutje, Gjykata Supreme vëren se faktet në vijim janë të pakontestueshme: një mjet shpërthyes është vendosur në katin përdhese të një ndërtese në rrugën Bill Clinton, Prishtinë dhe ka shpërthyer më 24 shtator 2007; ky shpërthim ka shkaktuar vdekjen e N.M.dhe P.S.dhe u ka shkaktuar lëndime të rënda trupore Xh.S., V.Z., L.N. G.S., E.H., N.H., F.B., L.K.dhe Sh.S.. Dispozitivi përfshin të gjitha informatat e përshkruara më lart. Për më tepër, vërtetimi i secilit detaj të vogël të akteve të të akuzuarve si kur është vendosur mjete shpërthyes dhe kur ka shpërthyer, lloji i eksplozivit apo si është aktivizuar është e panevojshme pasi që ato nuk janë relevante për natyrën kriminale të aktit të kryer apo për përgjegjësinë penale të të pandehurve. Gjithashtu, dispozitivi përmend motivin si bazë e përgjegjësisë penale dhe arsyetimi më tutje shtjellon motivin.

¹³ Me theks të veçantë nga Gjykata Supreme

¹⁴ Me theks të veçantë nga Gjykata Supreme

C. Vërtetimi i gjendjes faktike

14. Sa i përket pretendimit për përdorimin selektiv të provave pa dhënë arsyetim lidhur me kredibilitetin e provave, Gjykata Supreme rikujton se sipas parimit të vlerësimit të lirë të provave siç është përcaktuar me nenin 152 paragrafit 2 të KPPK-së, është prerogativë e trupit gjykues që të vlerësojë provat e prezantuara madje edhe kur ato janë kontradiktore. Kjo është për shkak se Gjykata e Qarkut pasi që ka dëgjuar drejtpërdrejt provat është në pozitën më të mirë që të vlerësojë kredibilitetin e dëshmitarëve dhe/apo ekspertëve. Është detyrë e Gjykatës Supreme që të përcaktoj nëse gjykata e faktit ka bërë vlerësimin në mënyrë të duhur. Prandaj, Revizioni i Gjykatës Supreme i vlerësimit të Gjykatës së Qarkut është i kufizuar vetëm në çështjen nëse faktet janë eksploruar me kujdes, nëse provat e prezantuara kanë qenë të pranueshme dhe nëse vlerësimi është i besueshëm, logjik dhe i kuptueshëm. Gjykata e shkallës së parë ka diskrecion mbi vlerësimin e provave në të cilën Gjykata Supreme nuk do të ndërhyjë përderisa aktgjykimi i apeluar nuk ka bërë shkelje të rregullave logjike dhe të arsyeshme. Gjykata Supreme bën rivlerësimin e provave vetëm nëse konstaton se vlerësimi i gjykatës së faktit është i gabuar.

15. Gjykata Supreme vëren se aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në përgjithësi thekson atmosferën e frikës së dëshmitarëve.¹⁵ *Më tutje vëren se “... një kulturë e frikës në mesin e dëshmitarëve ... vlen për dëshmitarët O. dhe Th., M.I.” dhe se “një konspiracion i heshtjes ... F.C.dhe S.S...” dhe gjithashtu “... kanë një interes i cili sidoqoftë është në kundërshtim me detyrën e tyre që ta thonë të vërtetën (A.B.dhe A. I.)”*¹⁶ Ky është një vlerësim fillestar i kredibilitetit të këtyre dëshmitarëve.

16. Aktgjykimi gjithashtu vëren se “Dëshmitarët kanë qenë klientë ... të barit ‘Passage’ i cili gjendet në të njëjtën ndërtesë ku ka ndodhur shpërthimi dhe i cili është shkatërruar nga shpërthimi, apo persona të pranishëm në afërsi të vendit të krimit për shkak të vendit të punës ...”. Vlerësimi vazhdon duke theksuar se “Deklaratat e tyre në gjykatë japin një përshkrim homogjen të ngjarjeve me një divergjencë shumë të kufizuar. ... Nga dëshmitë e ndryshme del se ...”¹⁷ Aktgjykimi në fjalë konstaton se “Dëshmitarët në të vërtetë kanë përshkruar në mënyrë të saktë ... gjë e cila shkon në favor të vërtetësisë dhe origjinalitetit të tyre.”¹⁸ Ky është një vlerësim i besueshmërisë së dëshmitarëve të tyre.

¹⁵ Për shembull shih aktgjykimin e datës 22 shtator 2012, faqe 8 të versionit në gjuhën angleze: “*Me disa përjashtime, secili dëshmitar ka treguar apo shprehur shqetësimin e tij/ saj për dhënien e dëshmisë.*”

¹⁶ Aktgjykimi i datës 22 shtator 2012, faqe 10 e versionit në gjuhën angleze

¹⁷ Aktgjykimi i datës 22 shtator 2012, faqet 11 – 12 të versionit në gjuhën angleze

¹⁸ Aktgjykimi i datës 22 shtator 2012, faqja 13 e versionit në gjuhën angleze

17. Aktgjykimi konstaton se dëshmitë e palëve të dëmtuara Xh.S., V.Z., L.N si dhe të dëshmitarëve Beta, Delta, Epsilon, Gamma, E.H.dëshmitarit Një dhe dëshmitarit Zeta “... japin një përshkrim homogjen të ngjarjeve me divergjenca shumë të kufizuara.”¹⁹ Pastaj i njëjti vazhdon me përshkrimin e atyre ngjarjeve dhe në fund nxjerr përfundime nga këto dëshmi.
18. Dëshmitë e dëshmitares M.I.ishin po ashtu dëshmi të rëndësishme për gjetjet e Gjykatës së Qarkut. Dëshmia e kësaj dëshmitareje është shtjelluar në mënyrë të detajuar në këtë aktgjykim.²⁰
19. Dëshmitarët A.B.²¹, A.T.²², R. M.²³, M. A.²⁴, O.²⁵ dhe Th.²⁶ janë dëgjuar lidhur me rrethanat të cilat lidhen me vrasjen e NB²⁷, të cilat dëshmi kanë vlerën e provave rrethore në këtë lëndë. Aktgjykimi konstaton se “Në përgjithësi, të gjithë treguesit shkojnë në favor të besueshmërisë së deklaramëve të dëshmitarëve O. dhe Th., si dhe të dëshmitarëve M. dhe A.; deklaramet e dëshmitarit B. japin motivin dhe aspektin racional të tërë kësaj historie.”²⁸
20. Sa u përket deklaratave të dëshmitareve Z. I. dhe E. I., është e qartë se aktgjykimi i vlerëson të njëjtat si jo të besueshme.²⁹ Lidhur me deklaratat e dëshmitarëve D. T., A. G. dhe R. Sh.aktgjykimi i sqaron dhe i vlerëson të njëjtat në mënyrë adekuate.³⁰ Aktgjykimi e përshkruan dëshmitarin A.J si “burim kompetent” dhe bën përmbledhjen e gjetjeve të tij.³¹ Në aktgjykim shkruan se “A.A., e cila duhej të ishte mbështetja kryesore e alibisë, ka ndryshuar versionet e saja disa herë gjatë fazës së zhvillimit të hetimeve dhe të gjykimit”³² dhe më tej vazhdon me përshkrimin se si dëshmia e saj nuk ka mundur të pasqyrojë të vërtetën. Aktgjykimi bën përmbledhjen e dëshmisë së dëshmitarit F.C., duke vlerësuar se “Megjithatë, kjo dëshmi i ka dhënë kolegjit një përshtypje të qartë se dëshmitari ishte i përgatitur dhe se i referohej rrethanave për të cilat i kërkohej t’i përsëriste,”³³ dhe duke vazhduar me sqarimin e arsyeve për të cilat kolegji kishte

¹⁹ Aktgjykimi i datës 22 shtator 2012, faqet 11 – 12 të versionit në gjuhën angleze

²⁰ Aktgjykimi i datës 22 shtator 2012, faqet 15 – 20 të versionit në gjuhën angleze

²¹ Aktgjykimi i datës 22 shtator 2012, faqja 23 e versionit në gjuhën angleze

²² Aktgjykimi i datës 22 shtator 2012, faqet 24 - 25 të versionit në gjuhën angleze

²³ Aktgjykimi i datës 22 shtator 2012, faqet 25 – 26 të versionit në gjuhën angleze

²⁴ Aktgjykimi i datës 22 shtator 2012, faqet 25 – 26 të versionit në gjuhën angleze

²⁵ Aktgjykimi i datës 22 shtator 2012, faqet 26 – 27 të versionit në gjuhën angleze

²⁶ Aktgjykimi i datës 22 shtator 2012, faqet 26 – 27 të versionit në gjuhën angleze

²⁷ Aktgjykimi i datës 22 shtator 2012, faqja 21 e versionit në gjuhën angleze

²⁸ Aktgjykimi i datës 22 shtator 2012, faqja 28 e versionit në gjuhën angleze

²⁹ Aktgjykimi i datës 22 shtator 2012, faqja 31 e versionit në gjuhën angleze

³⁰ Aktgjykimi i datës 22 shtator 2012, faqja 36 e versionit në gjuhën angleze

³¹ Aktgjykimi i datës 22 shtator 2012, faqja 40 e versionit në gjuhën angleze

³² Aktgjykimi i datës 22 shtator 2012, faqja 42 e versionit në gjuhën angleze

³³ Aktgjykimi i datës 22 shtator 2012, faqet 41 – 42 të versionit në gjuhën angleze

arritur tek një përfundim i tillë. Lidhur me dëshminë me shkrim të R.B. aktgjykimi konstaton se “... në mënyrë të qartë nuk mund të garantojë vërtetësinë e saj, ashtu sikur edhe dëshmitari në fjalë.”³⁴ Aktgjykimi vëren se “... nga deklaratat e B.Sh.nuk është e mundur të gjendet ndonjë konfirmim esencial i alibisë së parashtruar nga ana e B.H.t.”³⁵ Dëshmia e dëshmitares S.S.në këtë aktgjykim vlerësohet si në vazhdim: “Plotësisht e paaftë për t’i kujtuar qoftë edhe gjërat më kryesore ... ajo tregoi një precizitet të jashtëzakonshëm kur bëhej fjalë për natën e cila i parapriu shpërthimit të bombës deri në atë masë sa t’i kujtohej edhe një ... bisedë telefonike ... ajo kishte mbushur deklaratën e vet me sqarime të pabesueshme, absurde në përpyetje për ta përputhur deklarin e saj me versionin e A.A.t.”³⁶ Dëshmitarja G.H.ka dëshmuar rreth pushimit mjekësor dhe terminëve. Edhe pse aktgjykimi nuk lidhet me vlerësimin e dëshmisë së tij me emër të tij, i njëjti konstaton se dëshmia e tij nuk mund të përdoret për apo kundër të pandehurve.³⁷ Ngjashëm, dëshmitë e I.G., i cili kishte dëshmuar rreth asaj se kush i kishte përdorur veturat zyrtare, shënimet e udhëtimit dhe armët e përdorura, si dhe dëshmitë e B.R, i cili kishte dëshmuar rreth shënimeve të udhëtimit dhe mirëmbajtjes së veturës, vlerësohen se nuk kanë ndonjë vlerë provuese por pa përmendur emrat e këtyre.³⁸

21. Aktgjykimi konstaton se “... alibia e B.H.t është e pabazë ngase bazohet në dëshmitë jo të besueshme dhe të rrejshme të dëshmitarëve (A.A., R.B., F.C.dhe S.S.) të cilët erdhën në gjykatë thjesht për të dhënë deklaratat të fabrikuara.”³⁹
22. Aktgjykimi nuk iu referohet dëshmive të dëshmitarëve në vazhdim: S.K., M. J A.F., S.D’o, H.M., F.M.dhe F.V..
23. S.K. është polic i cili ka punuar një kohë të shkurtër në stacionin policor të Kaçanikut prandaj edhe e njeh B.H.n. Ai po ashtu e njeh Sh.Q.n dhe N. C. si policë. Dëshmia e tij është e pështjelluar pasi që në fillim deklaroi se nuk kishte ditur për ndonjë armiqësi nga ana e këtyre policëve ndaj E.S., ndërsa më vonë i njëjti thotë se “Ne e urrejmë atë si i dyshuar jo pse kam diçka personale me të.”⁴⁰ Ai po ashtu pohon se mesazhi të cilin ia kishte dërguar B.H.t “... fillimisht nuk i ishte drejtuar B.H.t por një kolegu tjetër, por të njëjtin gabimisht ia kishte

³⁴ Aktgjykimi i datës 22 shtator 2012, faqet 43 – 44 të versionit në gjuhën angleze

³⁵ Aktgjykimi i datës 22 shtator 2012, faqja 44 e versionit në gjuhën angleze

³⁶ Aktgjykimi i datës 22 shtator 2012, faqja 43 e versionit në gjuhën angleze

³⁷ Aktgjykimi i datës 22 shtator 2012, faqja 37 e versionit në gjuhën angleze

³⁸ Aktgjykimi i datës 22 shtator 2012, faqja 36 e versionit në gjuhën angleze

³⁹ Aktgjykimi i datës 22 shtator 2012, faqja 44 e versionit në gjuhën angleze

⁴⁰ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor të datës 14 maj 2009, faqja 29 e versionit në gjuhën angleze

- dërguar B.H.t.*”⁴¹ Prandaj, Gjykata Supreme konstaton se dëshmia e S.K. nuk e mbështet por as nuk e kundërshton pafajësinë e B.H.t.
24. M.J. është një polic i cili ka punuar me B.H.n. Ai ka deklaruar se pasi nuk ka qenë vozitës i veturës nuk i ka kontrolluar tabelat e regjistrimit por prapëseprapë ishte i sigurt që fundjavën e hedhjes së bombës, ai dhe I.G. kishin përdorur veturën zyrtare në të cilën më vonë u gjetën gjurmët e lëndëve shpërthyesë. Ai gjithashtu ka deklaruar se regjistrin e udhëtimit duhet ta plotësojë vozitësi i veturës dhe në këtë rast vozitës ka qenë I.G.. Regjistri i udhëtimit ka dy kolona të ndara për veturën në fjalë – njëra për “I.” ndërsa tjetra për “M.”. Gjykata Supreme është e mendimit se M.J. ka pranuar se nuk kishte nënshkruar regjistrin e udhëtimit, nuk kishte vozitur veturën dhe nuk kishte kontrolluar vërtet tabelat e regjistrimit të veturës me të cilën kishte udhëtuar, prandaj nuk mund të pohojë me siguri se cilën veturë e kishin shfrytëzuar ai dhe I.G..
25. A.F. është një polic dhe dëshmia e tij ka të bëjë me shpjegimet në fjalë të raporteve të policisë në shkresat e lëndës. S.D’o ka qenë hetuesi kryesor i këtij rasti dhe ka dhënë dëshminë e tij lidhur me rrjedhën dhe metodat e hetimeve të kryera. F.H. ka qenë hetues në këtë rast. F.V. është polic dhe dëshmia e tij ka qenë e koncentruar rreth uniformave të shfrytëzuara nga policia gjatë kohës së shpërthimit.
26. Dëshmia e H.M.t ka të bëjë vetëm me N. C., prandaj si e tillë nuk është e rëndësishme për ankesat të cilat janë duke shqyrtuar.
27. Gjykata Supreme është e mendimit se Gjykata e Qarkut ka vlerësuar në mënyrë të hollësishme besueshmërinë e dëshmitarëve. Gjykata Supreme nuk gjen ndonjë lëshim në këtë vlerësim të bërë.
28. Sa i përket pohimit se dëshmitarët e dëgjuar kanë dëshmuar për një rast tjetër, Gjykata Supreme konstaton se në bazë të nenit 152 të KPPK-së, Gjykata mund të pranojë dhe të shqyrtojë çdo provë për të cilën konsideron se ka vlerë provuese. Sipas nenit 360, paragrafit 5 të KPPK-së, trupi gjykues ka kompetenca për të marrë prova. Prandaj, dëgjimi i këtyre dëshmitarëve nuk ka shkelur kodin e procedurës penale.
29. Lidhur me njoftimin se ekzistojnë së paku edhe katër të dyshuar të tjerë lidhur me këtë rast të cilët nuk janë gjykuar ende si dhe pretendimin se të gjithë të

⁴¹ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor të datës 14 maj 2009, faqja 27 e versionit në gjuhën angleze

pandehurit duhet të gjykohen së bashku, Gjykata Supreme konstaton se një gjë e tillë do të ishte e dëshirueshme por nuk paraqet bazë për anulimin e aktgjykimit.

A. Pretendimet për shkeljen e kodit penal

30. Gjykata Supreme vëren se aktgjykimi i apeluar jep arsyetimin lidhur me atë se për çfarë arsye trupi gjykues ka konstatuar se vrasja e rëndë dhe lëndimi i rëndë trupor janë provuar.⁴² Gjykata Supreme në aktgjykimin e vet ka ndryshuar aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut duke deklaruar se vepra penale e vrasjes së rëndë mbulon veprën e shkakimit të rrezikut të përgjithshëm.
31. Më tej, Gjykata Supreme thekson se ekziston një dallim në mes të shprehjes qëllim siç përdoret në gjuhën e përditshme dhe shprehjes “dashje” siç përcaktohet me nenin 15 të KPPK-së. Dashja eventuale e përcaktuar me nenin 15, paragrafin 3 të KPPK-së mbulon po ashtu edhe ato situata në të cilat personi nuk ka dashur drejtpërdrejt një epilog të caktuar, por ka qenë i vetëdijshëm se pasoja e ndaluar mund të shkaktohet si rezultat i veprimit ose i mosveprimit të tij dhe pranon shkaktimin e saj.
32. Gjykata Supreme pajtohet me arsyetimin e Gjykatës së Qarkut lidhur me veprat penale të vrasjes së rëndë dhe të lëndimit të rëndë trupor si dhe me konstatimet e saj.

B. PËRFUNDIMET

33. Gjykata Supreme nuk ka identifikuar sipas detyrës zyrtare asnjë shkelje të ligjit (sipas nenit 415, paragrafit 1 të KPPK-së), të cilat nuk janë trajtuar në ankesën e mbrojtjes.
34. Duke u bazuar në të gjitha këto që u thanë më lart, është vendosur si në dispozitiv.

Sot më 16 janar 2013
Api – Kži – 6 / 2012

Kryetari i kolegjit

Procesmbajtësja

Martti Harsia

Noora Aarnio

⁴² Aktgjykimi i datës 22 shtator 2012, faqet 46 – 48 të versionit në gjuhën angleze

Anëtari i kolegjit

Charles Smith, III

Anëtari i kolegjit

Avdi Dinaj

Anëtarja e kolegjit

Elka Filcheva-Eremenkova

Anëtarja e kolegjit

Gyltene Sylejmani